



Universiteti Shtetëror i Tetovës
Државен Универзитет во Тетово
State University of Tetova

Republika e Maqedonisë, 1200 Tetovë-Tetovo, Rr.-Ul. Ilinden-Ilindenska Rektorati i Univerzitetit-Rektorat na Univerzitetot
Republic of Macedonia, www.unite.edu.mk Tel: ++389 44 356 500 Fax: 334-222

Në bazë të nenit 98 paragrafi 8 të Ligjit për Arsim të lartë (“Fletorja zyrtare” e R. Maqedonisë, nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 63/2004, 55/2005, dhe 113/2005) nenit 91 paragrafi 9 të Ligjit për Shkollimin e mesëm (“Fletorja zyrtare” e R. Maqedonisë, nr. 44/95, 24/96/34/96, 35/97, 82/99, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 63/2004, 55/2005 dhe 113/2005) dhe të Vendimit për përgatitje të kandidatëve për provimin e drejtorit të shkollave fillore dhe të mesme nr. 11-4277/2 të datës 25.07.2006 dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Rektoratit të datës 30. 08. 2006 në lidhje me pranimin e kandidatëve për Programin përgatitor për provimin e drejtorit të shkollave fillore dhe të mesme:

Universiteti Shtetëror i Tetovës
shpall

K O N K U R S

Për pranimin e kandidatëve për Programin përgatitor për provimin e drejtorit të shkollave fillore dhe të mesme

I. **Kushtet për aplikim të kandidatëve për trajnim të drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme në USHT:**

- A. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët **kanë kryer shkollim sipëror 4 vjeçar.**
- B. Të kenë **mbi 4 vjet përvojë pune, në arsimin fillor ose të mesëm.**

II. **Afati i paraqitjes për regjistrimin e kandidatëve.**

Afati i parë i paraqitjes

- 1. **Paraqitja e dokumentacionit në USHT bëhet në sportelet e Arkivit të Rektoratit, edhe atë duke filluar prej datës 09.02 (e premte) dhe zgjatë deri me 16.02.2007 (e premte).**

IV. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

- ✚ **Fletëparaqitja** për aplikim (e cila mund të merret në sportelet e Arkivit të Rektoratit USHT-së ose në web faqen zyrtare të Universitetit <http://www.unite.edu.mk/>)
- ✚ **Diploma e noterizuar.**
- ✚ **CV (biografi e shkurtër) në formë ese**
- ✚ **Certifikatën e lindjes.**
- ✚ **Vërtetim shëndetësor** – që do ti përmbajë të dhënat për gjendjen psiko-fizike të kandidatit¹. (nuk kërkohet **Çertifikatë shëndetsore**)
- ✚ **Vërtetim për pagesën e 15.000,00 denarëve** për harxhime administrative paguar në xhirollogarinë e USHT-së: 160016005478810, deponent Banka Popullore e Maqedonisë, llogaria 1000000000630095, thirur në numrin 723019, programi 40.

V. **Fillimi i programit për trajnimin e kandidatëve për drejtor të shkollave fillore dhe të mesme**

- 1. Programi për trajnimin e drejtorëve do të filloje prej **17.02.2007.**
- 2. Pas përfundimit të programit përgatitor **kandidatët do të marrin Çertifikatë për kryerje të suksesshme të programit përgatitor për drejtor** dhe e fitojnë të drejtën që ti **nënshtrohen provimit për drejtor të shkollave fillore dhe të mesme.**

Konkursi është i shpallur edhe në web faqen e universitetit: <http://www.unite.edu.mk/>

¹ Vërtetimi shëndetësor merret te mjeku amë.